



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2022:227313
Datë: 08.06.2023
Numri i dokumentit: 04375947

C-IV-15-0943

M D nga Fshati Piranë, Komuna e Prizrenit

Paditësi

Kundër:

Agjencia Kosovare e Privatizimit, me seli në Prishtinë, Rr. "Dritan Hoxha", nr. 55, Lakrishtë

E paditura

DHOMA E POSAÇME E GJYKATËS SUPREME TË KOSOVËS PËR ÇËSHTJET NË LIDHJE ME AGJENCINË KOSOVARE TË PRIVATIZIMIT (Dhoma e Posaçme), gjyqtari Mr.sc. Bajram Miftari, me datën 08.06.2023, mori këtë:

AKTGJYKIM

I. **Miratohet** si bazuar kërkesëpadia e paditësit M D dhe NDRYSHOHET vendimi i Agjencisë Kosovare të Privatizimit - Autoritetit të Likuidimit PRZ002-0161 i datës 04.05.2015, ashtu që:

Detyrohet e paditura që në emër të pagave të pa paguara për periudhën shtator 2008-qershor 2009, t'ia paguaj paditësit shumën prej 1,638.50 €, si dhe shumën prej 163.00 €, në emër të kamatës së vonesës prej 10 % të shumës së detyrimit bazë, në shumën totale për pagesë prej 1,801.50 €, në pajtim me prioritetet sipas kategorisë së përcaktuar të kërkesave dhe interesave të përcaktuara me ligjin e aplikueshëm për likuidimin e NSH-ve.

II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

Rrethanat procedurale të çështjes

Me datën 04.06.2015, paditësi M D ka paraqitur ankesë pranë Dhomës së Posaçme, kundër të paditurës Agjencia Kosovare e Privatizimit (në vazhdim: AKP), me të cilën ka kërkuar rishikimin e vendimit të Autoritetit të Likuidimit (në vazhdim: AL), PRZ002-0161.

Pala paditëse e ka titulluar parashtresën si “ankesë”, mirëpo gjykata të njëjtën e konsideron si padi, konform nenit 35.1 të Ligjit për Dhomën e Posaçme, e cila dispozitë bënë trajtimin e barabartë të parashtresave me të cilat bëhet “*nisja e procedurave*” pran Dhomës së Posaçme, pavarësisht faktit se a quhen padi, kërkesa apo ankesa.

Pala paditëse në padi ndër të tjera është theksuar: pranë Autoritetit të Likuidimit ka parashtruar kërkesë kreditore dhe se Autoriteti i Likuidimit kërkesën e parashtruar e ka refuzuar si të pa bazuar. E ka kundërshtuar pretendimin e palës së paditur në lidhje me parashkrimin e kërkesës. Po ashtu ka theksuar se Ligji për Punën e Bashkuar nuk është ligj i cili është në fuqi. I ka propozuar gjykatës që ankesën ta miratoj si të bazuar dhe me aktgjykim te anulohet vendimi me numër PRZ002-0161, dhe t’i njohët e drejta në kompensim. Bashkëngjitur me padinë ka dorëzuar vendimin e AL-së, me numër PRZ002-0161.

Me datën 01.03.2023, e paditura ka paraqitur përgjigje në padi, ku ndër të tjera ka theksuar: Objekt i kësaj procedure është vetëm ligjshmëria e vendimeve të AL-së, respektivisht përputhshmëria e tyre me Ligjin 04/L-034, për AKP-në. Padia e parashtruar nga pala paditëse duhet të bazohet në pretendimin se procesi i likuidimit nuk është kryer në përputhje me Ligjin 04/L-034. E ka kundërshtuar pretendimin e palës paditëse e cila ka theksuar se AL ka zbatuar në mënyrë të gabuar nenin 608 te Ligjit për Punën e Bashkuar. Ka pretenduar se kërkesa kreditore e paditësit është e parashkruar bazuar në nenin 608 te Ligjit për Punën e Bashkuar. Me përgjigje në padi është propozuar që të refuzohet kërkesëpadia, si dhe të vërtetohen vendimet e lëshuara nga AL.

Me datën 28.03.2023, pala paditëse ka parashtruar përgjigje në përgjigje në padi ku ndër të tjera e ka bërë edhe precizimin e kërkesëpadiës. I ka propozuar gjykatës që pas shqyrtimit të provave të marr aktgjykim me të cilin do ta anuloj vendimin me numër PRZ002-0161, dhe të detyrohet pala e paditur që në emër të kompensimit të pagave për periudhën shtator 2008-qershor 2009, t’ia paguaj shumën prej 1,653.55 €.

Me datën 24.04.2023, pala e paditur ka parashtruar kundërpërgjigje në përgjigjen e palës paditëse ku ndër të tjera ka theksuar se rregull bazik i procedurës civile është se pala paditëse e ka barrën e provave dhe se pala paditëse nuk ka parashtruar asnjë argument te ri në lidhje me pretendimet e dhëne me padi. I ka kundërshtuar pretendimet e dhëne me padi si të pa bazuara dhe se kërkesëpadia duhet te refuzohet.

Gjendja faktike e konstatuar

Me nenin 8.1 të LPK- së është përcaktuar: “*Se cilat fakte do t’i konsiderojë të provuara e cilat jo, vendosë vetë gjykata në bazë të çmuarjes me ndërjegje, e të kujdesshme të provave, por edhe në bazë te rezultatit të gjithë procedimit. Gjykata me ndërjegje dhe me kujdes e çmon ç’do provë veç e veç dhe të gjitha provat së bashku*”.

Pala paditëse ka dorëzuar provat si në vijim: Tabelen me analizë të pagave të pa paguara dt.31.08.2009; listën e punëtorëve përfitues te 20 %-it; kopjen e librezës së punës; lista e pagave

për periudhën shkurt 2008-korrik 2008; dhe listën e pranimit të njoftimit për ndërprerje të marrëdhënies së punës.

Me qëllim të vërtetimit të saktë dhe të plotë të gjendjes faktike, gjykata ka bërë analizën e fakteve dhe provave të prezantuara nga palët në procedurë, konform rregullave që rrjedhin nga neni 8.1 i LPK-së dhe dispozitat tjera ligjore të ndërlidhura. Nga parashtrimet e palëve në procedurë dhe analiza e provave të prezantuara, gjykata ka ardhur në përfundimin se faktet vendimtare të prezantuara nga pala paditëse, janë jo kontestuese, madje të mbështetura edhe në provat që ka prezantuar, si në vijim:

- Paditësi ka qenë punëtorë i NSH Kosova Vera, me seli në K të V, Komuna e Rahovecit, deri me fillimin e procedurës së privatizimit të sajë, respektivisht deri me datën 31.03.2010 kur AKP-ja i ka dërguar njoftimin për ndërprerjen e marrëdhënies së punës. Ka paraqitur kërkesë kreditore pran AL, për pagesën e pagave te pa paguara për periudhën deri me datën 31.08.2009, në shumën prej 1,653.55 €. AL e ka refuzuar kërkesën kreditore në tërësi dhe gjatë gjykimit ka pretenduar se kërkesa kreditore e parashtruar nga pala paditëse është e parashkruar.
- Në këtë çështje juridike ishte jo kontestuese se pala paditëse ka qene punëtor i ndërmarrjes deri në momentin e privatizimit të ndërmarrjes, respektivisht deri më 31.03.2010. Po ashtu, nga provat e lëndës është konstatuar se paga mujore e palës paditëse në ndërmarrje ka qenë në shumën prej 163.85 €. Pala e paditur nuk e ka kontestuar faktin se pala paditëse gjatë kësaj periudhe ka qenë në marrëdhënies pune në ndërmarrje, po ashtu nuk e ka kontestuar as lartësinë e pagës te cilën pala paditëse e ka pasur në ndërmarrje.
- Pala e paditur ka dhënë përgjigje të gjeneralizuara dhe nuk e ka trajtuar çështjet konkrete të rastit, nga të cilat varet zgjidhja e drejtë dhe e ligjshme e rastit. Pala e paditur nuk i ka kontestuar pretendimet konkrete te paditësit e as provat e dorëzuara prej tij. Nga përmbajtja e deklarimeve të palës së paditur rezulton se në esencë nuk është kontestuar gjendja faktike e pretenduar nga pala paditëse. Gjykata e ka pranuar si të vërtet gjendjen faktike te pretenduar nga pala paditëse dhe të provuar mjaftueshëm me provat e dorëzuara.

Arsyetimi ligjor

Procedura gjyqësore pran Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet në Lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në vazhdim: Dhoma e Posaçme), është e rregulluar Ligjin për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet në Lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Ligji nr. 06/L-086, i publikuar në gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, nr. 12/27, Qershor 2019), si ligj special. Përveç kësaj, si ligj procedural i përgjithshëm zbatohet Ligji për Procedurën Kontestimore (Ligji nr. 03/L-006), me ndryshimet dhe plotësimet e mëvonshme. Kjo çështje është definuar me Ligjin për Dhomën e Posaçme, neni 76, paragrafi 3, ku është theksuar, se “*në interpretimin dhe zbatimin e këtij ligji, kudo që është e*

nevojshme për të zgjidhur një çështje procedurale që nuk trajtohet mjaftueshëm me këtë ligj, Dhoma e Posaçme do të zbatojë mutatis mutandis dispozita përkatëse të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore”.

Ligji për Dhomën e Posaçme, neni 74, i jep të drejtën palës (kreditorit në procedurë të likuidimit) që të ushtroj mjetin juridik - ankesën kundër vendimit të AL-së, pran Dhomës së Posaçme. Sipas të njëjtës dispozitë ligjore, Dhoma e Posaçme mund të nxjerrë aktgjykim për vërtetimin, shfuqizimin apo ndryshimin e vendimit të AL-së, varësisht prej epilogut të procesit gjyqësor dhe në zbatim të dispozitave ligjore të aplikueshme.

Gjykata fillimisht ka shqyrtuar se a është e nevojshme mbajtja e seancës dëgjimore me palët në procedurë apo çështja mund të vendoset në bazë të materialeve në lëndë. Këtë çështje nuk e adreson Ligji për Dhomën e Posaçme si ligj special, por vetëm LPK si ligj procedural i përgjithshëm. Me LPK, neni 4, është përcaktuar se:

- Neni 4.1: Gjykata vendos për kërkesëpadinë pas shqyrtimit të çështjes juridike në seancë të drejtpërdrejtë dhe publike.

- Neni 4.2: Ndryshe nga dispozita e paragrafit 1 të këtij neni, gjykata vendosë për kërkesëpadinë në bazë të veprimeve procedurale të shkruara dhe provave të administruara në mënyrë jo të drejtpërdrejt, po që se kjo përcaktohet me ligj.

Një rast të tillë të përcaktuar me të njëjtin ligj ku mund të merret vendim meritor pa pasur nevojë që të mbahet seancë dëgjimore, e kemi të rregulluar me nenin 398 të LPK-së, ku është përcaktuar si në vijim:

“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë”.

Po ashtu, me nenin 152 të LPK-së (aktgjykimi pa shqyrtim kryesor të çështjes), është përcaktuar: *“Po që se i padituri me anë të përgjigjes në padi i ka pohuar faktet vendimtare, përkundrejt kontestimit të kërkesëpadiës, gjykata mundet pa caktuar seance gjyqësore, të jep aktgjykim (neni 143 dhe 147 të këtij ligji), nëse nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e tij”.*

Siç është shtjelluar më sipër, në këtë çështje kontestimore, faktet vendimtare të rastit nuk janë kontestuese. Sikurse vendimi i AL-së i atakuar me padi, ashtu edhe përgjigja në padi e paraqitur nga AKP-ja dhe parashtrimet e tjera të mëvonshme, nuk i kontestojnë faktet dhe rrethanat në të cilat thirret pala paditëse në kërkesën kreditore dhe me kërkesëpadi. Por, refuzimi i kërkesës është mbështetur vetëm në pretendimin se kërkesa kreditore është e parashkruar.

Duke u bazuar në faktet dhe rrethanat e lartë përmendura dhe në zbatim të dispozitave ligjore të cituara më sipër, gjykata ka ardhur në përfundimin se janë përmbushë kushtet ligjore për të nxjerrë vendim meritorë (aktgjykim) në këtë fazë të procedurës shkresore dhe se mbajtja e

seancës dëgjimore në këtë rast, është e panevojshme. Nga parashtrimet e palëve në procedurë dhe provat e shqyrtuara, rezulton se kontesti në mes të palëve në procedurë është i natyrës së pastër ligjore, ku pala e paditur ka pretenduar se ka qenë punëtor i NSH-së dhe se NSH-ja nuk ia ka paguar pagat për periudhën shtator 2008-qershor 2009, ku ka kërkuar shumën prej 1,653.55 €. Ndërsa në anën tjetër pala e paditur ka pretenduar se në rastin konkret kërkesa kreditore e palës paditëse është e parashkruar.

Gjykata fillimisht e ka shqyrtuar pretendimin e ngritur nga pala e paditur e cila me përgjigje në padi ku ka pretenduar në parashkrim të kërkesës kreditore. Gjykata potencon se sikurse legjislacioni që ishte në fuqi para vitit 1998/99, ashtu edhe ligjet që janë miratuar pas viteve 1998/1999, e kanë ruajtur afatin tre (3) vjeçar të parashkrimit të kërkesave monetare nga lëmi i marrëdhënies së punës. Me Ligjin për Punën e Bashkuar (Gazeta Zyrtare nr. 53/76), neni 608 parashihej se *“pagesa e shumës së pagës apo rrogës, apo secilës kërkesë tjetër të punëtorit që rrjedh nga marrëdhënia e punës, do të jetë e parashkruar për tri vite”*. Ligji për Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD), i vitit 1978 (Ligj nr. 690), neni 372.1 përcaktonte se *afati i parashkrimit të kërkesave periodike është tri vite, nga rrjedhja e secilës dhënie të veçantë për pagesë*. Ligji i Punës, i vitit 2010 (Ligj nr. 03/L-212), neni 87, përcakton se *të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës*. Edhe LMD i ri, i vitit 2012 (Ligj nr. 04/L-077), neni 353.1, ka përcaktuar se *“Kërkesat e dhënieve periodike që rrjedhin vit për vit ose në afate të caktuara më të shkurtra (kërkesat periodike) ... parashkruhen tri (3) vjet nga arritja e secilës dhënie të veçantë për pagesë”*. Nga përmbajtja e këtyre dispozitave ligjore, rezulton se afati i parashkrimit të kërkesave monetare nga marrëdhënia e punës, është tri vite, nga dita e arritjes për pagesë të secilës kërkesë veç e veç

Pas shqyrtimit të provave të lëndës pretendimeve dhe parashtrimeve të palëve në procedurë gjykata ka ardhur në përfundimin se në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me parashkrim të kërkesës. Deri te ky konstatim gjykata ka ardhur duke u bazuar në faktin se letër pezullimi i datës 31.03.2010, me të cilin pala paditëse është njoftuar se i ndërpritet marrëdhënia e punës është theksuar se pagat që janë borxh (kërkesat kreditore) mbesin përgjegjësi e punëdhënësit dhe se këto kërkesa do të trajtohen në procedurën e likuidimit. Sipas bindjes së gjykatës ky letër pezullim ka shkaktuar ndërprere të rrjedhës së afatit të parashkrimit të kërkesës së palës paditëse.

Me Shtojcën e Ligjit për AKP-në, neni 40 (Prioritetet e kërkesave dhe interesave), kërkesat për paga janë kategorizuar në grupin e kërkesave të pasiguruara, ndërsa kërkesat për tri paga janë kategorizuar si kërkesa preferenciale. Siç është konstatuar më sipër në këtë aktgjykim, paditësi ka pasur pagën mujore në shumën prej 163.85 € dhe se për periudhën shtator 2008-qershor 2009, i takojnë 10 paga mujore në shumën prej 1,638.50 €.

Vendimi për kumatën e vonës është i bazuar në neni 37.3 të Shtojcës së Ligjit për Dhomën e Posaçme, ku është përcaktuar se *“Të gjitha Kërkesat e bëra ndaj Ndërmarrjes mund të përfshijnë kumatë në çfarëdo shumë themelore të grumbulluar deri para datës së Vendimit të Likuidimit, me kushte që kjo kumatë të mos tejkalojë 10% (dhjetë për qind) të shumës themelore”*.

Duke u bazuar në faktet dhe rrethanat e lartë cekura dhe në dispozitat ligjore të cituara më sipër, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Shpenzimet gjyqësore

Vendimi për shpenzimet procedurale është marrë në bazë të nenit 62.5 të Ligjit për Dhomën e Posaçme, ku është përcaktuar se “*Nëse pala e suksesshme nuk i kërkon shpenzimet ose nëse ashtu vendos Dhoma e Posaçme, atëherë secila palë i bartë shpenzimet e veta*”. Në këtë rast gjyqësor, asnjëra nga palët në procedurë nuk ka kërkuar kompensimin e shpenzimeve procedurale. Prandaj, gjykata ka vendosur që secila palë do të bartë shpenzimet e veta.

Udhëzimi juridik

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim pranë Dhomës së Posaçme, brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e dorëzimit të tij, e cila i drejtohet Kolegjit të Apelit pranë Dhomës së Posaçme, konform nenit 9.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

Gjyqtari,
Mr.sc. Bajram Miftari